

VENDIM
Nr. 114, datë 21.4.2026

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 46, DATË 17.2.2026,
“MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ‘DEVOLL HYDROPOWER’ SHA
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/5 prot., datë 17.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 46, datë 17.2.2026 ‘Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 46, datë 17.2.2026, vendosi të rinovojë licencën nr. 343, seria F16/F21, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 81, datë 9.6.2016, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 134, datë 7.6.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 11.6.2026.

- Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar, se: “brenda datës 31.3.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës, ndërsa në pikën 3 i është lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrimet tatimore menjëherë sapo ta disponojë atë”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Me shkresën nr. 20/3 prot., datë 19.2.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 46/2026, duke i sjellë në vëmendje detyrimin për depozitimin e kontratës së rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit, si dhe depozitimin e vendimit të gjykatës në lidhje me detyrimet tatimore, menjëherë sapo ta disponojë atë.

- Me shkresën e saj të datës 31.3.2026, protokolluar në ERE me nr. 134/4 prot., datë 1.4.2026, shoqëria ka depozituar kontratën e qirasë të rinovuar për disponimin e zyrave, ku përcaktohet se periudha e vlefshmërisë është nga data 1.4.2026 deri më 31.3.2027.

- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit shoqëria ka bërë me dije se nuk ka ende një vendim të gjykatës dhe ka shprehur gatishmërinë e saj për të depozituar në ERE vendimin e formës së prerë menjëherë pas disponimit të tij. Si e tillë, kjo pikë mbetet e pandryshuar.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Afati i përcaktuar në kontratën e rinovuar nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës, ndaj lind nevoja për t’u ndryshuar pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46/2026, ku të përcaktohet, se: “shoqëria duhet të depozitojë brenda datës 31.3.2027, kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës”.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet,

shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, lind nevoja për të ndryshuar pikën 2 të vendimit nr. 46/2026 me përmbajtje si vijon: “2. Brenda datës 31.3.2027, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 46, datë 17.2.2026, si vijon:

a) Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 46, datë 17.2.2026, ndryshon dhe bëhet: “2. Brenda datës 31.3.2027, shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë për përdorimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit ose një dokument në lidhje me disponimin e tyre për periudhën e mbetur të licencës”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a., “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti